



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

KABINETI I KRYETARIT / URED PREDSEDNIKA / CABINET OF THE PRESIDENT

Prishtinë, më 6 shkurt 2015

Ref.: KK 17/15

Z. Sylë Hoxha

u. d. i Kryeprokurorit të Shtetit

Ndërtesa e ish-Bankës së Lubjanës, kati VIII

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Lënda: Informim për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13

I nderuari u. d. Kryeprokuror i Shtetit, z. Hoxha,

Gjykata Kushtetuese e Republikës, bazuar në kompetencat e përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën.

Më nenin 113 të Kushtetutës janë përcaktuar qartë palët e autorizuar që kanë të drejtën e referimit të çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Në kuadër të këtij neni, Kushtetuta, përveç organeve të shtetit, ka përcaktuar që edhe individët (personat fizikë dhe juridikë) kanë të drejtën e kontestimit të vendimeve të autoriteteve publike përkitazi me shkeljen e të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Që nga themelimi i Gjykatës Kushtetuese e deri më tash, pothuajse 99% e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë zbatuar nga përgjegjësit e drejtpërdrejtë për zbatimin e tyre, sipas urdhrorit të dhënë nga Gjykata në aktgjykimet e saj.

Gjykata Kushtetuese, duke e qenë e përkushtuar që të ndjek procedurat e zbatimit të vendimeve të saj deri në realizimin e plotë të të drejtave të parashtrueseve që dalin nga vendimet e saj, ka identifikuar një rast i cili ende nuk ka gjetur zbatim nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre, më konkretisht nga Agjencia Kosovare e Pronës.

Rasti konkret që ende nuk ka gjetur zbatim nga ana e autoritetit zbatues, është Aktgjykimi nr. KI187/13, i 1 prillit 2014, në të cilin Gjykata ka gjetur shkelje të të drejtave të parashtruesit, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me

nenin 6.1 të KEDNJ-së; me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Gjykata, në aktgjykimet e saj, përcakton saktësisht autoritetin zbatues, i cili, me urdhër të Gjykatës, obligohet që në një afat të caktuar kohor të informojë Gjykatën përkitazi me veprimet e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës.

Më 1 prill 2014, Gjykata vendosi për meritat e rastit në fjalë. Më 16 prill 2014, Aktgjykimi u publikua në ueb-faqen zyrtare të Gjykatës. Nga kjo datë e deri më sot kanë kaluar më tepër se 9 (nëntë) muaj, që është trefishi i afatit që i është dhënë autoritetit zbatues – Agjencisë Kosovare të Pronës, për të zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës.

Megjithatë, nga informatat e pranuar, më 15 korrik 2014, nga autoriteti zbatues dhe më pas nga parashtruesi, më 2 tetor 2014 dhe më 29 nëntor, kuptojmë se Aktgjykimi i Gjykatës sonë nuk është zbatuar dhe një lajm i tillë natyrisht se është shqetësues jo vetëm për Gjykatën Kushtetuese, si gardian i kushtetutshmërisë, por edhe për të gjitha institucionet e tjera publike që garantojnë sundimin e ligjit dhe që sigurojnë zbatueshmërinë e vendimeve gjyqësore, në përgjithësi.

Përkitazi me moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Kushtetuta në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve], përcakton: *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”*.

Me këtë nen të Kushtetutës është përcaktuar qartë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat e institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk janë thjesht të karakterit deklarativ, pra nuk bëjnë thjesht kualifikim të çështjes nëse një çështje e ngritur është kushtetuese apo jokushtetuese, por që vendimet e Gjykatës kanë efekt të drejtpërdrejtë konstituiv juridik. Në këtë kontekst, vendimet e Gjykatës kanë efekt të detyrueshëm për adresantin/adresantët (autoriteti përgjegjës për zbatim) dhe duhet të zbatohen detyrimisht nga institucioni i përmendur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Duhet pasur parasysh se, çdo refuzim i zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga ana e adresantit, përbën shkelje të nenit 116 të Kushtetutës dhe është në kundërshtim me sundimin e ligjit dhe me konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Për më tepër, moszbatimi i vendimeve të gjykatave, sipas nenit 402 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përbën vepër penale. Citojmë:

“Neni 402 Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore

1. Personi zyrtarë apo personi përgjegjës i cili refuzon të ekzekutojë urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës apo i cili nuk e ekzekuton vendimin brenda afatit ligjor apo afatit të caktuar me vendim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

2. Nëse me veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është shkaktuar shkelje e rëndë e të drejtave njerëzore apo dëm substancial material, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

3. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni e ekzekuton vendimin e plotfuqishëm të gjykatës, ndjekja nuk do të ndërmerret”.

Gjykata, në rastet kur vendimet e saj nuk zbatohen nga autoritetet e caktuara për zbatim, me rregullin 63 (7) të Rregullores së punës, ka paraparë: “Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar”.

Gjykata dëshiron të tërheq vëmendjen e institucioneve shtetërore që, në saje të kompetencave dhe të detyrimeve kushtetuese që kanë, të sigurojnë mekanizma për t'i zbatuar vendimet e saj, në përputhje të plotë me nenin 116.1 të Kushtetutës.

Prandaj, ju ftojmë që, në bazë të detyrimeve kushtetuese dhe të kompetencave që keni, të ndërmerrni të gjitha veprimet e duhura kundër adresantëve që nuk kanë zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, me ç'rast kanë bërë shkelje të nenit 116.1 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në realizimin e plotë të funksionit të saj të gardianit të Kushtetutës dhe të garantuesit të të drejtave të njeriut. Për realizimin e këtyre qëllimeve, Gjykata mirëpret bashkëpunimin me ju, gjithmonë në interes të respektimit të kushtetutshmërisë dhe të sundimit të ligjit.

Me respekt,

Prof. dr. Enver Hasani

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese



Bashkëngjitur:

1. Kopja e Aktgjykimit KI187/13
2. Informata e përditësuar për rastin KI187/13

CC: **Nadežda Jovanović**

Rr. “Vatroslav Lisinski”, nr. 21/19
Beograd, Republika e Serbisë

CC: **Projekti për Ndihmë Juridike**

“Školska”, b.b., 10500 Graçanicë
Republika e Kosovës